



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2022:121629

Datë: 07.06.2024

Numri i dokumentit: 05794229

C.nr.385/2022

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC – Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, gjyqtari Berkan Hamza, në çështjen juridike kontestimore të paditësve I.A, N.M, M.A, R.A dhe M1.A, të cilët i përfaqëson av. S.M nga Prizreni, sipas autorizimit në shkresat e lëndës, kundër të paditurës E me seli në Prishtinë, për shkak të kompensimit të dëmit, me datë 06.07.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. OBLIGOHET shërbimi financiar i kësaj gjykate që shumën prej 200.00 Euro, të deponuar në emër të paradhënies për përpilimin e ekspertizës nga lëmi i komunikacionit, ta transferojë në xhirollogarinë bankare të ekspertit B.K, përkatësisht me emrin e biznesit B. SK .K B.I., në xhirollogarinë bankare me numër nr.....-B.

A r s y e t i m

Paditësit I.A, N.M, M.A, R.A dhe M1.A, të cilët i përfaqëson av. S.M nga Prizreni, në këtë gjykatë, me datë 14.06.2022, kanë parashtruar padi kundër të paditurës E me seli në Prishtinë, për shkak të kompensimit të dëmit.

Pala paditëse, në këtë çështje kontestimore, me datë 08.12.2023, ka deponuar në arkë paradhënien për përpilimin e ekspertizës nga lëmi i komunikacionit në shumë prej 200.00 Euro. Gjykata, me datë 13.03.2024, ka pranuar ekspertizën e lartcekur, të përpiluar nga eksperti B.K, andaj vlerëson se janë plotësuar kushtet ligjore që paradhënia të transferohet tek eksperti, në emër të përpilimit të kësaj ekspertize, përkatësisht ekspertit B.K t'i transferohet shuma prej 200.00 Euro, si në pikën I të dispozitivit të këtij aktvendimi.

Andaj, bazuar në nenin 81 lidhur, me nenin 387 par. 1 pika (o) të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC

C.nr.385/2022, datë 07.06.2024

Gjyqtari
Berkan Hamza

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.